|           | Qendra e Zhvillimit Korçë                              | 1         | mjek                 | 4 orë/ditë | vjetore                        |
|           | Qendra e Zhvillimit Vlorë                              | 1         | mjek                 | 4 orë/ditë | vjetore                        |
|           | Qendra e Zhvillimit Berat                              | 1         | mjek                 | 4 orë/ditë | vjetore                        |
|           | Qendra Pritëse e Viktimave të Trafikimit               | 1         | sanitar              | 4 orë/ditë | vjetore                        |
|           | Qendra e Trajtitimit të Viktimave të Dhunës në Familje | 1         | sanitar              | 4 orë/ditë | vjetore                        |
| <b>28</b> | <b>Prokuroria e Përgjithshme</b>                       | <b>4</b>  |                      |            |                                |
|           | Prokuroria e Apelit për Krimet e Rënda                 | 1         | sanitar              | 4 orë/ditë | vjetore                        |
|           | Prokuroria e Apelit Përmet                             | 1         | sanitar              | 4 orë/ditë | vjetore                        |
|           | Prokuroria e Apelit Durrës                             | 1         | sanitar              | 4 orë/ditë | vjetore                        |
|           | Prokuroria e Apelit Shkodër                            | 1         | sanitar              | 4 orë/ditë | vjetore                        |
| <b>29</b> | <b>Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor</b>       | <b>2</b>  |                      |            |                                |
|           | Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor              | 1         | sanitar              | 4 orë/ditë | vjetore                        |
|           | Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda          | 1         | sanitar              | 4 orë/ditë | vjetore                        |
| <b>57</b> | <b>Qendra Kombëtare Kinematografike</b>                | <b>1</b>  |                      |            |                                |
|           | Qendra Kombëtare Kinematografike                       | 1         | sanitar              | 4 orë/ditë | vjetore                        |
| <b>66</b> | <b>Avokati i Popullit</b>                              | <b>2</b>  |                      |            |                                |
|           | Avokati i Popullit                                     | 1         | sanitar              | 4 orë/ditë | vjetore                        |

|           |                                                   |            |                                   |            |          |
|-----------|---------------------------------------------------|------------|-----------------------------------|------------|----------|
|           | Avokati i Popullit                                | 1          | punëtor mirëmbajtje               | 6 orë/ditë | vjetore  |
| <b>77</b> | <b>Autoriteti i Konkurrencës</b>                  | <b>1</b>   |                                   |            |          |
|           | Autoriteti i Konkurrencës                         | 1          | teknik i mesëm                    | 6 orë/ditë | vjetore  |
|           | Autoriteti i Konkurrencës                         | 1          | punonjës<br>protokoll/arkivi      | 6 orë/ditë | vjetore  |
| <b>87</b> | <b>Grupi 87</b>                                   | <b>1</b>   |                                   |            |          |
|           | Agjencia e Prokurimit Publik                      | 1          | sanitar                           | 6 orë/ditë | vjetore  |
| <b>93</b> | <b>Ministria e Energjisë dhe Industrisë</b>       | <b>36</b>  |                                   |            |          |
|           | Reparti Inspektim-Shpëtim Miniera                 | 6          | teknik emergjence dhe<br>shpëtimi | 6 orë/ditë | vjetore  |
|           | Reparti Inspektim-Shpëtim Miniera                 | 2          | nëpunës informacioni              | 6 orë/ditë | vjetore  |
|           | Aparati i MEI-t                                   | 2          | roje                              | 6 orë/ditë | vjetore  |
|           | Aparati i MEI-t                                   | 2          | sanitar                           | 4 orë/ditë | vjetore  |
|           | Inspektorati Qendror Teknik                       | 2          | sanitar                           | 4 orë/ditë | vjetore  |
|           | Inspektorati Qendror Teknik                       | 1          | punëtor mirëmbajtje               | 6 orë/ditë | vjetore  |
|           | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar                      | 16         | roje objekti                      | 6 orë/ditë | vjetore  |
|           | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar                      | 5          | teknik gjeolog                    | 6 orë/ditë | vjetore  |
| <b>94</b> | <b>Ministria e Zhvillimit Urban dhe Strehimit</b> | <b>211</b> |                                   |            |          |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 1                    | 25         | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2                    | 14         | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 3                    | 22         | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Durrës                      | 25         | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Elbasan                     | 22         | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë                       | 6          | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Shkodër                     | 15         | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Lezhë                       | 12         | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Vlorë                       | 25         | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Fier                        | 25         | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Kukës                       | 2          | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Dibër                       | 2          | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Gjirokastrë                 | 2          | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Drejtoria e ALUIZNI-t Berat                       | 3          | specialist drejtorie<br>rajonale  | 8 orë/ditë | vjetore  |
|           | Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit                 | 2          | roje                              | 6 orë/ditë | vjetore  |
|           | Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit                 | 1          | punonjës<br>protokoll/arkivi      | 6 orë/ditë | vjetore  |
|           | Agjencia Kombëtare e Turizmit                     | 1          | punëtor mirëmbajtje               | 4 orë/ditë | vjetore  |
|           | Agjencia Kombëtare e Turizmit                     | 1          | roje                              | 6 orë/ditë | vjetore  |
|           | Agjencia Kombëtare e Turizmit                     | 1          | sanitare                          | 6 orë/ditë | vjetore  |
|           | Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar        | 5          | mjeshtër shpimi                   | 8 orë/ditë | 6-mujore |
|           | <b>TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË</b>                 | <b>541</b> |                                   |            |          |



**VENDIM**  
**Nr. 36, datë 29.1.2014**

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE PUBLIKE**  
**PËR VITIN 2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2014, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Integrimit Evropian, Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, në Kryeministri, dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2014.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

LIDHJA NR. 1

**KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2014**

| PERIUDHA       | DATA                 | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS       | VEPRIMI PERKATES                                                                                                                                     |
|----------------|----------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Janar          | 10                   | MF                            | Përgatit dhe paraqet në KM Kalendarin e MSH                                                                                                          |
| Janar          | 15                   | KM                            | Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSH                                                                                                                |
| Janar          | 15                   | MF                            | Paraqet në KM Raportin mbi Vlerësimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Fiskale                                                                    |
| Janar          | 22                   | KM                            | Miraton Raportin mbi Vlerësimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Fiskale                                                                          |
| Janar          | 24                   | MF                            | Paraqet në KM Programin Ekonomik dhe Fiskal 2014-2017                                                                                                |
| Janar          | 29                   | KM                            | Shqyrton dhe miraton Programin Ekonomik dhe Fiskal 2014-2017                                                                                         |
| Shkurt         | 14                   | MF                            | Paraqet në KM tavanet e përgatitjes së PBA 2015-2017 dhe limitet e angazhimeve të reja                                                               |
| Shkurt         | 19                   | KM                            | Shqyrton dhe miraton tavanet e përgatitjes së PBA 2015-2017                                                                                          |
| Shkurt         | 25                   | KM                            | Paraqet për informacion në Kuvend, Raportin mbi Vlerësimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Fiskale si dhe Tavanet e përgatitjes së PBA 2015-2017 |
| Shkurt         | 28                   | MF                            | Dërgon Udhëzimin e Përgatitjes së Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme                                                                   |
| Shkurt - Prill | 28 Shkurt - 30 Prill | Njësitë e Qeverisjes Qendrore | Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore                                                                                                                 |
| Maj            | 1                    | Njësitë e Qeverisjes Qendrore | Paraqesin në MF kërkesat e tyre buxhetore                                                                                                            |
| Maj            | 1 - 20               | MF, MIE dhe DPZHFNH           | Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore                                                                                                               |
| Maj            | 21 - 30              | MF, MIE dhe DPZHFNH           | Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes Qendrore                                                                                         |
| Qershor        | 6                    | MF                            | Paraqet në KM Raportin mbi Vlerësimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Fiskale të Rishikuar                                                       |
| Qershor        | 11                   | KM                            | Miraton parashikimin e përditësuar Makroekonomik dhe Fiskal                                                                                          |
| Qershor        | 2-19                 | MF                            | Përgatit dokumentin e PBA 2015-2017, tavanet e reja të shpenzimeve të PBA 2015-2017 dhe limitet e angazhimeve të reja                                |
| Qershor        | 20                   | MF                            | Paraqet dokumentin e PBA 2015-2017, tavanet e reja të shpenzimeve dhe limitet e angazhimeve të reja, për shqyrtim dhe miratim në KM                  |
| Qershor        | 25                   | KM                            | Miraton dokumentin e PBA 2014-2016 dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA 2015-2017                                                                |
| Korrik         | 4                    | MF                            | I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2015-2017                                                                                        |
| Korrik         | 10                   | MF                            | Dërgon Udhëzimin Plotësues të Përgatitjes së Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme                                                        |
| Korrik - Gusht | 11 Korrik - 29 Gusht | Njësitë e Qeverisjes Qendrore | Përgatisin kërkesat e rishikuara buxhetore                                                                                                           |
| Shtator        | 1                    | Njësitë e Qeverisjes Qendrore | Paraqesin në MF kërkesat e rishikuara buxhetore                                                                                                      |
| Shtator        | 1-17                 | MF, MIE dhe DPZHFNH           | Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore                                                                                                 |
| Shtator        | 18-30                | MF, MIE dhe DPZHFNH           | Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes Qendrore                                                                                         |
| Tetor          | 3                    | MF                            | Paraqet në KM parashikimin e përditësuar Makroekonomik dhe Fiskal                                                                                    |
| Tetor          | 8                    | KM                            | Miraton parashikimin e përditësuar Makroekonomik dhe Fiskal                                                                                          |
| Tetor          | 1-17                 | MF                            | Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2015 si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2015-2017 dhe i paraqet për shqyrtim në KM                                |
| Tetor          | 22                   | KM                            | Miraton Projektbuxhetin e vitit 2015 si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2015-2017                                                                  |
| Tetor          | 31                   | MF                            | Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2015-2017, të miratuar nga KM                                           |
| Tetor          | 31                   | KM                            | I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin e vitit 2015                                                                                                      |



**VENDIM**  
**Nr. 37, datë 29.1.2014**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË**  
**TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1 të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Nga lista e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen individët e renditur në shkronjën “a” të listës “Lista e individëve të çregjistruar nga lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për Al-Qaida-n me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR**  
**SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTAT E OKB-SË)**

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN**  
**AL-QAIDA**

a) Lista e individëve të çregjistruar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”:

1. NABIL; BEN MOHAMED; BEN ALI; BEN ATTIA.
2. ATILLA; SELEK.

Shënim. Gjeneralitet e tjera për personat, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

**VENDIM**  
**Nr. 38, datë 29.1.2014**

**PËR DHËNIEN NË HUAPËRDORJE, PA KUNDËRSHPËRBLIM, NË FAVOR TË**  
**BASHKISË SË KORÇËS, TË NJË SIPËRFAQEJE PREJ 23 000 m<sup>2</sup> TOKË ARË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 901 e në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 5 të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënie në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, dhe të ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998 “Për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në huapërdorje, pa kundërshtpërblim, në favor të Bashkisë së Korçës, të pasurisë shtetërore nr. 30/2, ZK 8561, vol. 30, f. 70 dhe nr. 31/1, ZK 8561, vol. 30, f. 98, tokë arë, me sipërfaqe të përgjithshme 23 000 m<sup>2</sup>, në qytetin e Korçës, për realizimin e projektit të impiantit fotovoltaiik.

2. Afati i kontratës së huapërdorjes të jetë 30 (tridhjetë) vjet, me të drejtë ripërsëritjeje.

3. Të drejtat dhe detyrimet të përcaktohen në kontratën e huapërdorjes që do të lidhet ndërmjet palëve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Autorizohet Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për nënshkrimin e kontratës me Bashkinë e Korçës.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Bashkia e Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

VENDIM

Nr. 40, datë 29.1.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 532, DATË 7.7.2010 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONE USHTARAKE NË SHTABE TË  
NDRYSHME NË AFGANISTAN”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 532, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1.1, nënndarja “- Numri i pjesëmarrësve 3 (tre) ushtarakë.” zëvendësohet me “- Numri i pjesëmarrësve 5 (pesë) ushtarakë.”.

b) Në pikën 1.2, fjalët “... 31 dhjetor 2014 ...” zëvendësohen me “... 31 janar 2014...”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për çdo vit në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**



**VENDIM**  
**Nr. 41, datë 29.1.2014**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MJEDISEVE, NGA  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, AGJENCIA PËR  
MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE DHE KOMITETI SHTETËROR I  
MINORITETEVE TE MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**


1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të mjediseve, nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe Komiteti Shtetëror i Minoriteteve të Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, sipas planimeve bashkëlidhur këtij vendimi, për t’u përdorur si mjedise pune nga kjo ministri.

2. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 217, datë 2.2.2009 “Për dhënien në përdorim Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të një pjese të ndërtesës së ish-Ministrisë së Transporteve e Telekomunikacioneve”, nr. 223, datë 7.4.2010 “Për dhënien në përdorim Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile të disa mjediseve të ndërtesës së ish-Ministrisë së Transporteve e Telekomunikacioneve”, dhe nr. 249, datë 13.4.2010 “Për dhënien në përdorim Komitetit Shtetëror të Minoriteteve të disa mjediseve të ndërtesës së ish-Ministrisë së Transporteve e Telekomunikacioneve”, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Komiteti Shtetëror i Minoriteteve dhe kryeregjistruesi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**




PLANIMETRIA E KATIT TE PARE  
Ekzistuese



LEGJENDA

KOMISIONERI PER MBROJTJEN E TE DHENAVE PERSONALE



PLANIMETRIA E KATIT TE TRETE - Ekzistuese  
(Shtesa)



### LEGJENDA

|  |                                           |
|--|-------------------------------------------|
|  | AGJENSIA PER MBROJTJEN E SHQËRSISE CIVILE |
|  | KOMITETI SHQETOROR I MINORITETEVE         |

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

|  |                  |
|--|------------------|
|  | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Çmimi 16 lekë